

1

Kutia e viteve


Në rrafshin e përdoruesve të Riinvest Data ka katër kuti kryesore. Fillimisht mund të zgjedhni vitet për të cilat i kërkonit të dhënat. Vitet mund të zgjedhën individualisht ose edhe të gjitha së bashku duke zgjedhur opsionin **'Selekto të gjitha'**, siç edhe është ilustruar në imazhin e më poshtëm. Opsioni vijues **'Pastro të gjitha'** është mundësi përmes së cilës mund të anuloni zgjedhjen e të gjitha viteve; kjo mundësi është bërë e mundur për të gjitha kutitë në faqen e përdoruesit.

2000 2001 2002 2003 2004 2005 2007
 2011 2012 2013

Selekto të gjitha
 Pastro të gjitha

2

Kutia e Indikatorëve



Menjëherë poshtë kutisë së viteve, në kutinë e dytë, mund të zgjedhni **Indikatorët**. Në fillim janë rreshtuar **Indikatorët Kryesorë**, të tjerët vijojnë me renditje alfabetike dhe Indikatorët e fundit të listuar janë ata **Makroekonomik**. Pranë secilit indikator mund të shihni **'i'** ose informacionet, që ju tregojnë pyetjen e cila u është drejtuar respondentëve.

Në rast se informatat dëshironi të i merrni të ndara sipas viteve, atëherë gjithnjë zgjedhni indikatorin **'Viti'**, p.sh. vendoseni **'Viti'** si indikatorë X. Në të kundërtën do të gjeneroni vetëm mesataren e të gjitha viteve për indikatorët e zgjedhur.

3


Grafiku

Varësisht se nëse i vendosni indikatorët e përzgjedhur në kutinë X ose Y, rezultatet do të gjenerohen në boshtin X ose Y të grafikëve. Paraqitjen e grafikëve të përzgjedhur mund ta shihni nën të gjitha kutitë, te **seksioni i grafikut** në fund të faqes.

Shfaqja vizuale e të dhënave mund të zgjidhet në disa forma të grafikëve, që janë ilustruar në imazhin e mëposhtëm (p.sh. diagram me shtylla ose diagram rrethor). Në të njëjtën kuti, mund edhe të zgjedhni edhe të shkarkoni të gjitha të dhënat (opsioni **'Download'**).



4



Shembulli i grafikut

Në të majte mund të shihni grafikun për indikatorët **'Viti'** dhe **'Lokacioni'** i ndërmarrjes që janë përzgjedhur si indikatorë X (boshtin X), dhe **'Gjinia e pronarit të ndërmarrjes'** e vendosur si indikator Y.

riinvestinstitute.org/data

RIINVEST DATA



**UDHËZUESI PËR
PËRDORIMIN E PLATFORMËS
ELEKTRONIKE SË TË DHËNAVE
TË INSTITUTIT RIINVEST**

RIINVEST
1995

Platforma elektronike e shpërndarjes së të dhënave nga Instituti Riinvest përmban të dhëna të mbledhura nga ekipet hulumtuese të Riinvestit përgjatë 13 viteve, nga viti 2000 deri më 2013. Këto të dhëna janë mbledhur duke përdorur metodologjitë më të avancuara të anketimit për studime socio-ekonomike, dhe duke mbuluar mostra reprezentative të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) të cilat operojnë në Kosovë. Të dhënat përmbajnë 72 indikatorë që mbulojnë fusha të ndërlidhura me zhvillimin e sektorit privat sikurse: karakteristikat dhe performanca e ndërmarrjeve, investimet kapitale dhe praktikat biznesore, si dhe barrierat e të bërit biznes. Përdoruesve poashtu ju është mundësuar qasje në Indikatorët Makroekonomik për të cilët ka të dhëna nga institucionet e tjera lokale.



Për t'u qasur në databazë drejtohuni
në website te Institutit Riinvest

www.riinvestinstitute.org

dhe klikoni
në butonin

Data

Po ashtu mund të kyçeni direkt përmes

www.riinvestinstitute.org/data